

VENDIM
Nr. 377, datë 1.6.2022

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR. 228, DATË 29.2.2012,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES
PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE,
QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË–ELBASAN”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 228, datë 29.2.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Pika 3 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqen “tokë bujqësore” dhe “truall”, prej 634 712 (gjashtëqind e tridhjetë e katër mijë e shtatëqind e dymbëdhjetë) m², me vlerë të përgjithshme 215 870 150.2 (dyqind e pesëmbëdhjetë milionë e tetëqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e pesëdhjetë pikë dy) lekë, për objekte, me vlerë 157 232 702 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 373 102 852.2 (treqind e shtatëdhjetë e tre milionë e njëqind e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy pikë dy) lekësh.”.

2. Në pikën 4, vlera prej “... 10 637 500 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tridhjetë e shtatë mijë e pesëqind) lekësh...” zëvendësohet me vlerën prej “... 10 687 500 (dhjetë milionë e gjashtëqind e tetëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind lekësh...”.

3. Në pikën 5 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Vlera prej “... 365 550 631.2 (treqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e pesëqind e pesëdhjetë mijë e gjashtëqind e tridhjetë e një pikë dy) lekësh...” zëvendësohet me vlerën prej “...373 102 852.2 (treqind e shtatëdhjetë e tre milionë e njëqind e dy mijë e tetëqind e pesëdhjetë e dy pikë dy) lekësh...”;

b) Pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç”, me këtë përmbajtje:

“ç) 7 552 221 (shtatë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e dy mijë e dyqind e njëzet e një) lekë përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2022, për Autoritetin Rrugor Shqiptar.”.

4. Tabelës bashkëlidhur vendimit i hiqet pasuria nr. 125/5, zonë kadastrale 2735, me sipërfaqe të shpronësuar 1 739 m² (një mijë e shtatëqind e tridhjetë e nëntë), me vlerë kompensimi 405 187 (katërqind e pesë mijë e njëqind e tetëdhjetë e shtatë) lekë dhe i shtohet tabela që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut të Tiranës dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË PRONË PRIVATE TË TË CILËVE PREKEN NGA DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË VKM-në NR. 228, DATË 29.2.2012, “PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR TIRANË–ELBASAN, TË NDRYSHUAR”

Nr.	TË DHËNAT PËR PRONARIN					SIP. SHPRONËS. (m ²)	VLERËSIME T	Vlera (lekë)	VLERA	Shënime
	Emri i pronarit	Z.K.	NR. PAS.	LLOJI I PASURISË	SIP. TOTALE		ÇMIMI (LEKË/ m ²)		TOTALE (LEKË)	
1	Zamir Rexhep Metani	2735	113/27	arë	1,594	587	399	234,213	234,213	Konfirmim nga ASHK-ja
2	Zamir Rexhep Metani	2735	113/28	truall	456	456	3,560	1,623,360	1,623,360	Konfirmim nga ASHK-ja
3	B.P. Metani, Binaj, Aliko	2735	113/9	arë	5,000	1,742	399	695,058	695,058	Konfirmim nga ASHK-ja
4	Ismail Myrteza Kurtaj	1170	46/3	ullishte	800	190	375	71,250	71,250	Konfirmim nga ASHK-ja
5	Arben Hysen Cala	2704	484/6/1	arë	2,000	145	523	75,835	75,835	Konfirmim nga ASHK-ja
6	Arben Hysen Cala	2704	484/7	truall	2,000	104	3,283	341,432	341,432	Konfirmim nga ASHK-ja
7	Petrit Shefqet Fusha	2704	484/13	vresht	800	63	523	32,949	32,949	Konfirmim nga ASHK-ja
8	Zyber Mustafa Tarja	2752	19/2	arë	1,200	158	448	70,784	70,784	Konfirmim nga ASHK-ja
9	Mësar Liman Zhullima	1170	71/30	arë	16,500	1,166	375	437,250	437,250	Konfirmim nga ASHK-ja
10	Riza Vesel Beka	1977	126/2	arë	1,660	237	470	111,390	111,390	Konfirmim nga ASHK-ja
11	Sefer Hasan Sherifi	1977	125/10	pemëtore	2,910	2,910	470	1,367,700	1,367,700	Konfirmim nga ASHK-ja
12	Sami Hysmet Sherifi	1977	44/94	pemëtore	5,300	5,300	470	2,491,000	2,491,000	Konfirmim nga ASHK-ja
Vlera totale						13,058		7,552,221	7,552,221	

Vlerësimi për pasuritë e llojit “truall” dhe “arë”, “pemëtore”, “ullishte” dhe “vresht”, është bërë në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë.